



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

RREGULLA PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Prishtinë, 29 gusht 2011



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, paragrafin 3 dhe 4, Nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.16, si dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, në seancën e mbajtur më 29.08.2011, miratoi:

RREGULLËN PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGI

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Rregulla për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) përcakton strukturën e brendshme, organizimin, përfaqësimin, procesin e vendimmarrjes, natyrën e detyrave të punës, procedurën për punësimin e personelit, si dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit dhe personelit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Neni 2

Fushëveprimi

1. ZRRE-ja është agjenci e pavarur, që kryen rregullimin e aktiviteteve në sektorin e energjisë dhe është krijuar në pajtim me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë.
2. Zyra e Rregullatorit për Energji kryen funksionin, detyrat dhe përgjegjësitë e saj, të përcaktuara në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Ngrohjen Qendrore, Ligjin për Gazin Natyror, me këtë rregull, si dhe me ligjet dhe rregullat e tjera në fuqi në Kosovë.
3. ZRRE kryen aktivitetet e saj në mënyrë të pavarur, transparente dhe jodiskriminuese.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **“ZRRE”** - Zyra e Rregullatorit për Energji;
 - 1.2. **“Bordi”** - Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, ashtu siç është përcaktuar në Kreun II të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe përfshin kryesuesin e Bordit;
 - 1.3. **“Kryesuesi i Bordit”** – është njëri nga anëtarët e Bordit, i emëruar sipas Nenit 4 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.4. **“Personel”** - punonjësit e ZRRE-së, të emëruar në detyra përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.



2. Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Gazin Natyror dhe Ligjin për Ngrohjen Qendrore.

KREU II

Emri, selia dhe vula

Neni 4

Emri, selia dhe vula

1. Emri i Zyrës së Rregullatorit për Energji është:
 - 1.1. në shqip: Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE);
 - 1.2. në serbisht: Regulatorni Ured za Energiju (RUE), dhe
 - 1.3. në anglisht: Energy Regulatory Office (ERO).
2. Selia e Zyrës së Rregullatorit për Energji është në Prishtinë.
3. ZRRE-ja do të përdorë vulën zyrtare me emrin e Zyrës së Rregullatorit për Energji. Vula mund të përfshijë edhe simbolin ose shenjën dalluese të ZRRE-së.
4. Vula do të mbahet nga kryesuesi i Bordit të ZRRE-së ("Kryesuesi") ose ndonjë anëtar tjetër i ZRRE-së, i autorizuar nga kryesuesi.

KREU III

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE FUNKSIONIMI I ZRRE-SË

Neni 5

Struktura organizative

1. ZRRE do të ketë strukturën organizative që i përgjigjet veprimtarisë që kryen.
2. ZRRE-ja do të aprovojë dhe do të implementojë një strukturë organizative që do të vlerësohet si funksionale dhe e duhur për kryerjen në mënyrë efikase të obligimeve të saj. Struktura organizative mund të ndryshohet dhe të përshtatet sipas kërkesave që paraqiten në përmbushjen e obligimeve ligjore.
3. Numri i anëtarëve të personelit të punësuar në ZRRE do të përcaktohet në bazë të strukturës organizative dhe sipas kriterëve të punësimit të përcaktuara nga Bordi.



Neni 6 **Funksionimi**

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) funksionon si person juridik i pavarur, i përbërë nga Bordi dhe personeli.
2. ZRRE do të drejtohet nga Bordi si organ vendimmarrës, i cili përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, përfshirë kryesuesin e Bordit.

Neni 7 **Bordi i ZRRE-së**

1. Zyra e Rregullatorit për Energji drejtohet nga Bordi i emëruar në pajtim me Nenin 4 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
2. Anëtarët e Bordit nuk kanë statusin e shërbyesit civil. Të gjithë anëtarët e Bordit do të jenë në marrëdhënie të rregullt pune në Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe me orar të plotë.
3. Kryesuesi i Bordit mund t'u caktojë anëtarëve të tjerë të Bordit edhe detyra të tjera specifike, duke përfshirë edhe autoritetin e zëvendësimit të tij dhe, sipas nevojës, edhe përgjegjësinë e mbikëqyrjes së departamenteve apo njësive të veçanta të ZRRE-së, në bazë të një vendimi paraprak të Bordit.
4. Anëtarët e Bordit do të paguhën me paga mujore dhe mëditje të tjera në pajtim me ligjet e aplikueshme në fuqi.

Neni 8 **Mandati i anëtarëve të Bordit**

1. Mandati i secilit anëtar të Bordit fillon nga dita kur ai është emëruar në Bord, siç është përcaktuar në Nenin 4, paragrafi 4, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
2. Secili anëtar i Bordit mund të riemërohet për një mandat shtesë pesë (5) vjeçar.
3. Kushtet për emërimin e anëtarëve të Bordit janë të përcaktuara në Nenin 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 9 **Shkarkimi i anëtarëve të Bordit**

Kuvendi i Republikës së Kosovës mund ta shkarkojë nga pozita e tij një anëtar të Bordit, para skadimit të mandatit të tij/saj, vetëm në rastet e përcaktuara në Nenin 6 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.



Neni 10 Detyrat e Bordit

1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, Bordi:
 - 1.1. Do të miratojë politikat rregullative dhe operacionale të ZRRE-së;
 - 1.2. Do ta organizojë dhe do ta mbikëqyrë punën e ZRRE-së;
 - 1.3. Do ta organizojë punësimin, do të emërojë udhëheqësit e departamenteve dhe personelin e ZRRE-së dhe do të mbikëqyrë punën e tyre;
 - 1.4. Do të përgatisë dhe do të mbikëqyrë zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar të ZRRE-së, si dhe do të miratojë raportet dhe deklaratat financiare të saj;
 - 1.5. Do të miratojë nivelet e kompensimit dhe kushtet e tjera të punësimit për të punësuarit në ZRRE;
 - 1.6. Do të hartojë, miratojë dhe zbatojë aktet nënligjore, Kodet teknike, Rregullat, Urdhëresat, Vendimet dhe aktet e tjera individuale për rregullimin e sektorit të energjisë, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.7. Do të marrë pjesë aktive në mbledhjet që kanë të bëjnë me çështjet e rregullimit të sektorit të energjisë në vendet e BE-së dhe në rajon, si dhe në institucionet rajonale, duke promovuar interesat e Kosovës në tregun rajonal;
 - 1.8. Do të marrë vendime për të lëshuar, modifikuar, pezulluar, transferuar, përfunduar ose tërhequr licencat e ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitete të energjisë në Kosovë dhe për të cilat aktivitete kërkohet licenca;
 - 1.9. Do të marrë vendimet për aprovimin e tarifave dhe metodologjive tarifore;
 - 1.10. Do të marrë vendime në lidhje me lëshimin e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë në përputhje me Nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.11. Do të nxjerrë vendime për aktivitetet financiare dhe administrative;
 - 1.12. Do të përcaktojë të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të personelit;
 - 1.13. Do të përcaktojë detyra “ad-hoc” për çdo anëtar të personelit, në rast se e kërkon ngarkesa e punës në ZRRE, dhe në rast se anëtari i personelit i ka aftësitë dhe cilësitë për t’u marrë me detyrën që i është caktuar;
 - 1.14. Do të nxjerrë vendime për shqiptimin e masave administrative dhe gjobave në pajtim me Nenin 52 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.15. Do të nxjerrë vendime të tjera brenda kompetencave dhe përgjegjësi të veta, siç është përcaktuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë; dhe



- 1.16. Do të ndërmarrë aktivitete të tjera që mund të ndikojnë në përmirësimin e punës, ngritjen e kapaciteteve dhe efikasitetit të ZRRE-së.

Neni 11

Detyrat e kryesuesit të Bordit

1. Kryesuesi i Bordit do të jetë përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Bordit dhe:
 - 1.1. Do të thërrasë, do të caktojë dhe do të propozojë rendin e ditës dhe do të kryesojë seancat e Bordit;
 - 1.2. Do ta përfaqësojë ZRRE-në përpara palëve të treta;
 - 1.3. Do të bashkëpunojë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, donatorët dhe asociacionet për rregullatorët në sektorin e energjisë;
 - 1.4. Do të ndërmarrë të gjithë veprimet ligjore që të përfaqësojë ZRRE-në në të gjitha seancat përpara Kuvendit, gjykatave, organeve të administratës publike, etj.;
 - 1.5. Do të raportojë një herë në vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës për punën e ZRRE-së, në përputhje me Nenin 9 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë; dhe
 - 1.6. Do t'i raportojë komisionit përgjegjës funksional të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sa herë që kjo kërkohet.

Neni 12

Detyrat e tjera të kryesuesit të Bordit

1. Kryesuesi do t'i propozojë Bordit:
 - 1.1. Masat për përmirësimin e punës dhe efikasitetit të ZRRE-së;
 - 1.2. Masat dhe metodat për trajnime, shpenzimet për studime, analiza, ngritjen e kapaciteteve etj., që kanë të bëjnë me funksionet e ZRRE-së, në pajtim me Nenin 20 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.3. Delegimin e disa detyrave të anëtarët e tjerë të Bordit të ZRRE-së.

Neni 13

Detyrat administrative të kryesuesit të Bordit

1. Kryesuesi në emër të Bordit:
 - 1.1. Do të lidhë, do të ndryshojë dhe do të ndërpresë kontratat e punësimit të anëtarëve të personelit, në bazë të vendimit të Bordit;
 - 1.2. Do të aprovojë pushimet (vjetore dhe të tjera) të të gjithë anëtarëve të personelit;



2. Kryesuesi do të kryejë funksione të tjera që i janë caktuar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, me këtë rregull, si dhe me vendime të Bordit.

Neni 14

Zëvendësimi i kryesuesit të Bordit

Gjatë mungesës së tij, nëse është e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij, kryesuesi mund të autorizojë një nga anëtarët e Bordit që ta përfaqësojë (zëvendësojë) atë ose të kryejë detyra të tjera të veçanta.

Neni 15

Organizimi i departamenteve dhe funksionalizimi i tyre

1. Bordi i ZRRE-së, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi për kryerjen e aktiviteteve, krijon departamente përkatëse në kuadër të ZRRE-së.
2. Secili departament i ZRRE-së do të udhëhiqet nga Udhëheqësi i Departamentit, i emëruar nga Bordi, i cili ka për detyrë të organizojë, të kontrollojë, të planifikojë, të koordinojë, të raportojë, të vlerësojë stafin e tij/saj, dhe do të mbajë përgjegjësi për aktivitetet dhe përmbushjen e detyrave që i janë caktuar personelit në departamentin përkatës.
3. Departamenti dhe njësitë e tjera brenda ZRRE-së mund të krijohen ose të mbyllen ose t'iu ndryshohen përgjegjësitë, vetëm me vendim të Bordit.

KREU IV

PROCEDURA E ZHVILLIMIT TË SEANCAVE

Neni 16

Seancat e Bordit

1. Bordi do të mbajë të paktën dhjetë (10) seanca në vit. Kryesuesi ose ndonjë anëtar tjetër i Bordit mund të propozojnë që të mbahen seanca shtesë.
2. Përveç seancave të rregullta, Bordi mund të mbajë edhe seanca të veçanta për çështje urgjente.
3. Kuorumi për mbajtjen e seancave të Bordit është tre (3) anëtarë, pavarësisht nëse ka një (1) apo dy (2) pozita të lira të anëtarëve në Bord.
4. Kryesuesi i Bordit do të propozojë rendin e ditës për seancat e bordit dhe do t'ua dorëzojë rendin e ditës anëtarëve të tjerë të Bordit të paktën pesë (5) ditë pune para çdo seance.
5. Bazuar në rendin e ditës, anëtarëve të Bordit duhet t'u dërgohet i gjithë materiali përkatës.
6. Pas konsultimit me të gjithë anëtarët e Bordit, nëse paraqiten rrethana urgjente apo të jashtëzakonshme, kryesuesi mund të bëjë ndryshime në rendin e ditës.



7. Udhëheqësit e departamenteve ose çdo anëtar i personelit mund të ftohet që të marrë pjesë në një seancë të Bordit, në rast se kjo kërkohet për të sqaruar më mirë një rrethanë lidhur me çështjen në diskutim.
8. Brenda kompetencave të veta, Bordi në seanca do të diskutojë për çdo aplikacion, kërkesë, ankesë, ndryshim, miratim apo shfuqizim të legjislacionit sekondar apo akteve të tjera, shqyrtim të ndonjë ankese apo kërkesë të anëtarëve të personelit etj.
9. Sipas Nenit 24 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, seancat e Bordit janë të hapura për publikun, përveç në rastet e përcaktuara me Nenin 19 të kësaj rregulle, nëse diskutohen çështjeve konfidenciale (të fshehtësisë).
10. Në rast se në seancë do të marrin pjesë edhe palë të tjera, atëherë asistenti/ja e Bordit do të kujdeset që të mbajë një regjistër për pjesëmarrësit.
11. Pjesëmarrësit do të informohen se gjatë seancës së Bordit nuk kanë të drejtë të flasin, të bëjnë pyetje, të përdorin telefonat celularë, të ndërpresin fjalën e folësit etj., përveç nëse një gjë e tillë lejohet nga kryesuesi i Bordit. Pjesëmarrësit kanë të drejtë të mbajnë shënime.
12. Në rast të moszbatimit të këtyre kriterëve, kryesuesi i Bordit mund ta ndërpresë mbledhjen për të vazhduar më vonë (brenda ditës) apo mund të vendosë që mbledhja të mbahet një ditë tjetër.

Neni 17 **Zhvillimi i seancës**

1. Bordi zhvillon seancën në datën dhe në orën e caktuar në njoftimin e seancës të përgatitur dhe të shoqëruar me materialin përkatës.
2. Seanca drejtohet nga kryesuesi i Bordit dhe, në mungesë të tij, nga zëvendësi i caktuar sipas rastit nga kryesuesi, i cili, pasi verifikon prezencën e anëtarëve dhe të personelit të përfaqësuar, si rregull, nga udhëheqësit e departamenteve dhe përjashtimisht nga punonjës të tjerë që konsiderohen të rëndësishëm prej tij për mbarëvajtjen e seancës, procedon si më poshtë:
 - 2.1. Kryesuesi ose nëpërmjet asistentit/es lexon rendin e ditës dhe pyet anëtarët e Bordit nëse kanë ndonjë koment mbi rendin e ditës dhe radhën e procedimeve në mbledhje;
 - 2.2. Pas miratimit të rendit të ditës dhe deklarimit të mundshëm, në rast të ekzistimit të konfliktit të interesave nga ndonjë prej anëtarëve të Bordit, kryesuesi fton të prezantohet materiali i përgatitur nga personat e ngarkuar për shqyrtimin e çështjes që është në rendin e ditës;
 - 2.3. Në përfundim të prezantimit të materialit, personi prezantues i jep përgjigje pyetjeve të ndryshme të parashtruara nga Bordi. Më pas kryesuesi pyet punonjësit që prezantuan, materialin nëse kanë ndonjë gjë tjetër për të shtuar apo për të sqaruar në seancën e Bordit. Në vazhdim ftohen anëtarët e Bordit për të bërë pyetje apo për të kërkuar sqarime të tjera mbi materialin.



2.4. Në përfundim të procedurës së përcaktuar në nënparagrafin 2.3. të këtij neni, kryesuesi, si rregull, procedon me trajtimin në të njëjtën mënyrë të çështjes tjetër në rend dite, kur çështjet për diskutim në një seancë janë më shumë se një.

2.5. Pas trajtimit të çështjes në rend dite, sipas procedurës të përcaktuar në këtë neni, kryesuesi fton Bordin të votojë për çështjen që u trajtua në seancë.

Neni 18

Transparenca dhe informatat konfidenciale

1. Seancat e Bordit janë të hapura për publikun, përveç në rastet kur diskutohen materiale që konsiderohen si konfidenciale nga Bordi, sipas Nenit 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Në rastet kur Bordi konsideron se ndonjë personi mund t'i lejojë qasja në informatat konfidenciale që do të jenë në shqyrtim, atëherë atij mund t'i lejojë pjesëmarrja në seancë.
2. ZRRE, në përputhje me dispozitat e Rregullës për Informatat Konfidenciale, vendos kriteret për të përcaktuar konfidencialitetin e informatave dhe masat për mbrojtjen e tyre.
3. Në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale, kryesuesi dhe anëtarët e Bordit, si dhe anëtarët e personelit që kanë qasje në informata konfidenciale, janë përgjegjës për ruajtjen e këtyre informatave.
4. Bordi do t'i ndërmarrë të gjithë hapat që i konsideron të domosdoshëm për të njoftuar publikun e gjerë për punën që e bën, duke përfshirë seancat publike të Bordit, bashkëpunimin me mediat, publikimin e raporteve vjetore dhe materialeve të tjera, si dhe organizimin e konferencave për shtyp.

Neni 19

Asistenti/ja e Bordit

1. Asistenti/ja e Bordit do të asistojë në seancat e Bordit dhe nuk ka të drejtë vote. Ai/ajo është përgjegjës për:
 - 1.1. mbajtjen e shënimeve dhe/ose regjistrimin me zë (audio) ose video të seancës;
 - 1.2. përgatitjen e procesverbalit të seancës dhe qarkullimin e materialeve për nënshkrim;
 - 1.3. dërgimin e ftesave me shkrim për anëtarët e Bordit dhe pjesëmarrësit e tjerë;
 - 1.4. publikimin e njoftimit për mbajtjen e seancës në gazetën ditore dhe media të tjera, nëse kërkohet; dhe
 - 1.5. publikimin e njoftimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Neni 20

Mungesa në seancë të Bordit

1. Anëtarët e Bordit duhet të jenë të pranishëm në të gjithë seancat e Bordit. Nëse anëtari i Bordit do të mungojë në seancë, atëherë ai duhet ta njoftojë me shkrim Bordin për arsyet e mungesës së tij, përveç kur mungesa është për shkak të rrethanave si në vijim:
 - 1.1. nëse është në udhëtim zyrtar;
 - 1.2. nëse është në pushim të lejuar;
 - 1.3. në rast të sëmundjes.
2. Në procesverbalin e seancës do të shënohen emrat e anëtarëve të pranishëm dhe atyre që mungojnë. Shkresat që kanë të bëjnë me arsyet e mungesës së anëtarëve të Bordit do t'i bashkëngjiten procesverbalit të seancës përkatëse.

Neni 21

Miratimi i vendimeve të Bordit

1. Vendimet e Bordit miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në seancë. Megjithatë, asnjë vendim nuk mund të miratohet pa votën afirmative të së paku tre (3) anëtarëve të Bordit.
2. Asnjë nga anëtarët e pranishëm të Bordit nuk mund të abstenojnë nga votimi, përveç në rrethana të kufizuara, përfshirë konfliktin e interesit. Nëse ekzistojnë rrethanat e tilla, atëherë kërkohet që në procesverbal të regjistrohet sqarimi mbi shkaqet e abstenimit të kërkuar.
3. Çdo anëtar i Bordit ka të drejtë t'i propozojë Bordit aprovimin apo ndryshimin e ndonjë vendimi.
4. Anëtari i Bordit që nuk bie dakord për ndonjë vendim, mund të kërkojë që në procesverbalin e seancës të përfshihet deklarata e tij lidhur me arsyet për një qëndrim të tillë.
5. Vendimet do të nënshkruhen nga anëtarët e Bordit që kanë qenë të pranishëm në seancë dhe duhet t'u dërgohen palëve në kopje origjinale ose kopje të vërtetuara, ndërsa një kopje origjinale do të mbahet në arkivin e ZRRE-së.

Neni 22

Përfundimi i seancës së Bordit dhe nënshkrimi i procesverbalit

1. Në përfundim të seancës, kryesuesi do të bëjë përmbylljen e seancës dhe, eventualisht, do t'i informojë palët e interesuara lidhur me propozim-datën dhe kohën e mbajtjes së seancës së ardhshme.
2. Asistenti/ja i Bordit brenda tre (3) ditëve të punës do të përgatisë procesverbalin e seancës së mbajtur nga Bordi dhe do t'ua dërgojë anëtarëve të Bordit për komentet/vërejtjet eventuale lidhur me përmbajtjen e procesverbalit. Procesverbali nga seanca e Bordit do të nënshkruhet nga anëtarët e bordit brenda katër (4) ditëve të punës pas marrjes së procesverbalit.



3. Procesverbali i seancës do të përfshijë çështjet e diskutuara të rendit të ditës dhe ndryshimet e mundshme në të, numrin e anëtarëve të Bordit të pranishëm dhe atyre që mungojnë, emrat e personave të tjerë të thirrur për të marrë pjesë, të cilët janë të pranishëm dhe që mungojnë, çështjet e diskutuara nga personat pjesëmarrës në seancë, rezultatet e votimit, konkluzionet e mbledhjes, çdo deklaratë të anëtarëve të Bordit dhe palëve të tjera sipas kërkesës së tyre, dokumentet e prezantuara, përfundimet ose vendimet e marra dhe çdo informacion tjetër të diskutuar gjatë seancës.

Neni 23

Afati për dorëzimin e vendimeve të Bordit

1. Vendimet e Bordit do të përgatiten dhe do të dorëzohen te palët e interesuara brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data e aprovimit të vendimit.

KREU V

KONTRATAT DHE PAGAT

Neni 24

Kontratat e anëtarëve të Personelit

1. Anëtarët e personelit të ZRRE-së nuk e kanë statusin e nëpunësit civil.
2. Anëtarët e personelit fillimisht do të kenë kontrata pune një (1) vjeçare.
3. Bordi mund të vendosë që të rrisë kohëzgjatjen e kontratave të punës të anëtarëve të personelit të ZRRE-së në dy (2) apo më shumë vite, varësisht nga vlerësimi vjetor i përmbushjes së detyrave të punës individuale.
4. Termat dhe kushtet e kontratave të punësimit të anëtarëve të personelit do të përcaktohen nga Bordi.

Neni 25

Pagat e anëtarëve të Personelit

1. Anëtarët e personelit do të kenë paga mujore dhe mëditje të tjera në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
2. Pagat mujore për anëtarët e personelit të ZRRE-së do të përcaktohen nga Bordi i ZRRE-së, në bazë të së cilës Bordi i konsideron adekuate për funksionimin efikas, në varësi nga buxheti vjetor i ZRRE-së.
3. ZRRE, sipas nevojës, mund të angazhojë konsulentë, që të ndihmojnë gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të ZRRE-së. Nëse konsulentët do të paguheshin nga buxheti vetjak i Zyrës së Rregullatorit për Energji, ata do të angazhohen në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik.



Kreu VI Financimi i ZRRE-së

Neni 26

Burimet e financimit

1. ZRRE do të finanohet nga taksat e inkasuara në lidhje me licencimin e aktivitetet e tjera sipas Nenin 22 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Gjithashtu, për qëllim të zbatimit të përgjegjësisë të saj sipas ligjit, ZRRE mund të shfrytëzojë ndarje buxhetore sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 21 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
2. Menaxhimi dhe shfrytëzimi i fondeve të ZRRE-së do të bëhet në përputhje me Nenin 19 dhe 20 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 27

Procedura e menaxhimit financiar

1. Fondet e ZRRE-së do të mbahen në llogari të veçanta bankare në emër të ZRRE-së.
2. Ministria e Financave mund të caktojë auditimin e llogarive dhe aktiviteteve financiare të ZRRE-së, në pajtim me ligjet në fuqi.
3. Kryesuesi dhe një apo më shumë anëtarë të personelit të ZRRE-së do të kenë autoritetin nënshkruar dhe mbikëqyrës mbi përdorimin e fondeve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
4. ZRRE mban librat/regjistrat financiarë në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, të cilat përcaktojnë procedurën e kontabilitetit në Kosovë.

KREU VII PUBLIKIMI I DOKUMENTEVE

Neni 28

Publikimet i vendimeve dhe akteve të tjera

1. Vendimet e ZRRE-së do të publikohen në ueb faqen zyrtare të saj.
2. Vendimet që kanë të bëjnë me funksionimin dhe organizimin e brendshëm të ZRRE-së nuk do të publikohen në ueb faqen zyrtare të saj.
3. Rregullat e Zyrës së Rregullatorit për Energji publikohen në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Rregullatorit për Energji brenda dhjetë (10) ditësh pune pas miratimit të tyre.
4. ZRRE do të nxjerrë buletin dhe do ta publikojë atë në faqen elektronike zyrtare të internetit të paktën një herë në gjashtë (6) muaj.



5. Buletini do të përmbajë përshkrimin e akteve individuale dhe vendimet lidhur me licencat, tarifat, autorizimet etj.
6. Të gjitha rregullat, aktet individuale dhe vendimet e tjera, si dhe ato që kanë të bëjnë me licencat dhe tarifat, do të publikohen në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së brenda afatit të përcaktuar me Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
7. Asistenti/ja i Bordit do të mbajë regjistër mbi të gjitha vendimet dhe aktet e tjera të aprovuara nga Bordi. Regjistri do të publikohet në ueb faqen e ZRRE-së.

KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 29 Gjuha zyrtare

Kjo rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 30 Ndryshimi

1. ZRRE mund ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 31 Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 32 Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon Statutin e ZRRE-së, i nxjerrë në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9 dhe i miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 15.12.2005.



Neni 33
Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar